



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the
Chief State Prosecutor

A.nr.141/2023

Datë: 06.06.2023

Prishtinë

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, në pajtim me nenin 20 paragrafi 1 pika 1.6; të Ligjit Nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, në zbatim të dispozitës së nenit 154 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës për shqyrtimin e detyrueshëm të lëndës, me qëllim të unifikimit të praktikave të punës në prokuroritë themelore, Prokurorinë Speciale (PSRK) dhe Prokurorinë e Apelit nxjerr këtë:

UDHËZIM

Për zbatimin e detyrueshëm të dispozitës së nenit 154 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës,
lidhur më shqyrtimin e detyrueshëm të lëndës

1. Detyrohen të gjithë prokurorët dhe kryeprokurorët që çdo tre (3) muaj, të shqyrtojnë secilën lëndë dhe pas shqyrtimit, të konstatojnë nëse hetimi duhet të mbetet i hapur, të pezullohet, të pushohet apo të ngritët aktakuza.
2. Për këtë shqyrtim të lëndës duhet të bëhet shënim zyrtar, i cili do të jetë pjesë e shkresave të lëndës.
3. Mos respektimi i këtij udhëzimi konsiderohet si shkelje disiplinore e prokurorëve, sipas dispozitës së nenit 6 paragrafi 2 nënparagrafi 2.6 të Ligjit Nr. 06/l - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
4. Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Besim Kelmendi
Ushtrues i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit



Udhëzimi i dërgohet;

- Të gjithë Kryeprokurorëve dhe prokurorëve të shtetit;
- Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH).
- Obligohet administrata e ZKPSH-së që këtë udhëzim ta publikoj në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit.